



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

UDHËZUES MBI PËRDORIMIN E **STANDARDEVE PROFESIONALE** **GJATË ZHVILLIMIT TË** **MODULEVE MËSIMORE**



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian

PRISHTINË, 2011

EU KOSVET V

Zhvillimi i Sigurimit të Cilësisë, Akreditimit dhe Zhvillimi i AKK & KKK në Kosovë

Nr. i Projektit: 2009/216-809

Ky publikim është hartuar me përkrahjen e Bashkësisë Evropiane.
Përmajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e kontraktorit PEM GmbH dhe në asnjë mënyrë
nuk mund t'i pasqyrojë pikëpamjet e Bashkësisë Evropiane.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	6
2. Rezultatet e mësimit	6
3. Fokusi i Programit Mësimor	7
4. Formati i Modulit Mësimor	9
A. Informacionet e Përgjithshme	10
Titulli i Modulit	10
Data	10
Deklarata e Nivelit	10
Vlera e Kredisë	11
Deklarata e Qasjes	11
Parathënie e modulit	12
Rezultatet e mësimit	12
Kriteri i Përformancës/realizimit	15
Kushtet e realizimit të funksionit	16
Kërkesat e Dëshmive	17
Aneksi 1 – Taksonomia e foljeve sipas Bloom-it	21
Aneksi 2 – Zgjedhja e Metodave të Vlerësimit	24
Aneksi 3 – Moduli mostër	27

1. HYRJE

Sfida kryesore për zhvilluesit e kurrikulit dhe ofruesit e aftësimit është prodhimi i programeve mësimore të cilat mundësojnë zhvillimin e kompetencave profesionale dhe vlerave personale që e bëjnë të diplomuarin më të punësuar.

Në veçanti çështje në dizajnimin dhe zbatimin e programeve mësimore është nëse apo jo janë përmbushur kërkesat e punësimit. Kërkesat e punësimit ose kërkesat e vendit të punës janë të përshkruara në standarde profesionale.

Kështu që standardet profesionale duhet të përdoren për të siguruar një pikë referimi për identifikimin e moduleve që duhet të përfshihen në secilin kualifikim, së bashku me rezultatet e të mësimit që duhet të arrihen në mënyrë që kandidati të kreditohet për kryerjen e secilit modul.

Programet e mësimit janë themelet për arritjen e kompetencave dhe kualifikimeve. Kualifikimet përbëhen nga një numër i moduleve. Kualifikimet profesionale përfshinë modulet e detyrueshme dhe ato zgjedhore. Të dyja, modulet si ato të detyrueshme por edhe ato zgjedhore fillojnë në standarde profesionale të zhvilluara nga industria, andaj ekspertët në profesionet përkatëse duhet të vendosin në lidhje me kombinimin e moduleve të kërkuara për ndërtimin e kualifikimit të caktuar.

2. REZULTATET E MËSIMIT

Rezultatet e të mësimit/ mësimit janë deklarata që përshkruajnë shkathtësitë dhe njohurinë që një person pritet t'i fitojë përmes një programi ose kursi. Këto deklarata janë interpretime të informacionit të përfshira në kompetenca të gjetura në standarde profesionale.

Gjatë përgatitjes së rezultateve të mësimit për t'u përfshirë në një program ose kurs duke u bazuar në standarde profesionale, zhvilluesit duhet të egazminojnë kompetencat për të përcaktuar shkathtësitë dhe njohurinë.

Rezultatet e të mësimit janë një elaborim i informacioneve të përfshira në standardin profesional. Kjo është për shkak se informatat e dhëna në standardin profesional janë të një niveli më të përgjithshëm, nëse rezultati i të mësimit i referohet pikërisht asaj që **nxënësi është në gjendje të bëjë** dhe, natyrisht **të dëshmoj** në fund të programit mësimor.

∴ Duke dëshmuar shkathtësitë dhe njohurinë e përfshirë në standardin profesional, rezultatet e të nxënësve veprojnë si urë ndërmjet programit mësimor dhe standardit profesional. ∴

Rezultatet e mësimit gjithashtu munden:

- Udhëzojnë nxënësit në mësimin e tyre, në atë që u shpjegojnë nxënësve ëka pritet prej tyre .
- Stafin për tu fokusuar saktësisht në atë që nxënësit duhet të arrijnë për sa i përket njohurive, shkathtësive dhe kompetencave .
- Stafin në përzgjedhjen e mësimit të përshtatshëm, strategjive të mësimdhënies dhe vlerësimit .
- Të palët stafin dhe nxënësve në procesin e monitorimit të progresit .

3.

FOKUSI I PROGRAMIT MËSIMOR

Fokusi i një programi mësimor është ajo që ka për qëllim t'i siguroj nxënësit, pra temën e modulit. Nuk ekziston një rregull i artë për përzgjedhjen e temës së programit nga një sërë standardesh profesionale.

Në përgjithësi, funksionet kryesore të identifikuar në standarde profesionale do të shpjen në përkufizimin e moduleve për të mësuarit dhe vlerësimin por ky nuk është një opsion i vetëm.

Modulet janë blloqet ndërtuese të programit mësimor por edhe të kualifikimit, ato rrjedhin direkt nga përmbajtja e standardeve profesionale të cilave i referohen.

Për shembull funksioni **"Puno në mënyrë të sigurve , minimizo rreziqet dhe zbato procedurat e emergjencës"** mund të qojnë në zhvillimin e modulit **"Shëndeti dhe Siguria Profesionale"**.

Është poashtu e mundur ti qasemi tri funksioneve në një modul të vetëm por më të gjerë, ku rezultatet e pritura kanë pak rëndësi për kualifikimin nëse ato zbërthehen në disa module.P.sh. dy funksionet e veçanta për hidraulikun janë ' Instalimi i tubave të ujit dhe kanalizimit ' dhe 'instalimi i objekteve sanitare në banjo dhe kuzhina' . Zhvilluesit mund të vendosin të kenë një modul të vetëm "Elementet bazike të hidraulikut" që do të përfshij të dyja funksionet.



Fig. 1 Programet mësimore mund të zhvillohen duke u bazuar në një funksion




Fig. 2 Moduli i zhvilluar duke u bazuar në një grup funksionesh

Nganjëherë, gjatë analizës së përmbajtjes së njëres prej disa funksioneve vendosim që një mori e aktiviteteve kyçe mund të na shpie në zhvillimin e një moduli. Ky është rasti i interpretimit të specifikave teknike për caktimin e llojit të saldimit që do të përdoret gjatë bashkimit të pjesëve të metalit. 'Interpretimi i specifikave teknike' është zakonisht aktiviteti kyç i identifikuar për secilin dhe çdo funksion që lidhet me funksionet e ndryshme të saldimit të diferencuara nëpërmjet teknologjisë së përdorur - procesi i saldimit me hark metalik, MIG/MAG etj.

Këto opsione i lejojnë zhvilluesve dhe ofruesve të aftësimit fleksibilitet të madh në përgatitjen e programeve të tyre. Aspekti më i rëndësishëm pavarësisht qasjes së zgjedhur, është se zhvilluesit duhet të përqipen të mbaj procesin e zhvillimor të thjeshtë ti bazojnë kurset e tyre në atë mënyrë që programi i tyre mundet lehtë dhe qartë të shtegtohet ndaj funksionit dhe standardit profesional.




Fig. 3 Programet mësimore të zhvilluara nga aktivitetet kyçe ose nga njohuritë e veçanta të kërkuara për kryerjen e funksioneve të ndryshme

4.

FORMATI I MODULIT MËSIMOR

Propozohet që të gjitha kualifikimet e AAP-së në Kosovë, duhet të përdoret formati i moduleve si në vijim:

Titulli i Kualifikimit:

Titulli i Modullit:

Vlera e Kredisë:

Rezultatet e Mësimit :

1.

2.

Rezultati i Mësimit 1:

- Kriteri i Përformancës (vlerësimi) ...
- Kriteri i Përformancës (vlerësimi) ...
- Kriteri i Përformancës (vlerësimi) ...

Vargu (i kushteve, pajisjeve, veglave etj.), njohuria, shkathtësitë, qëndrimet
Strategjia e Vlerësimit

- Kërkesat e Dëshmime (format e dëshmime, sasia e dëshmime)
- Metodot e vlerësimit

Rezultati i Mësimit 2:

- Kriteri i Përformancës (vlerësimi) ...
- Kriteri i Përformancës (vlerësimi) ...
- Kriteri i Përformancës (vlerësimi) ...

Vargu (i kushteve, pajisjeve, veglave etj.), njohuria, shkathtësitë, qëndrimet
Strategjia e Vlerësimit

- Kërkesat e Dëshmime (format e dëshmime, sasia e dëshmime)
- Metodot e vlerësimit

Të gjitha specifikat e modullit duhet të paraqiten në të njëjtin format: Ekzistojnë dy komponente kryesore: Informacionet e Përgjithshme dhe Deklarata e Standardeve.

A. Informacionet e Përgjithshme përshijnë :

- Numri referues i Modullit
- Titulli i Modullit
- Data e Publikimit
- Niveli
- Vlera e Kredisë

- Deklarata e Qasjes
- Hyrje në Modullit
- Lista e Rezultateve të Mësimit/ Mësimit

B. Deklarata e Standardeve për secilin rezultat të mësimit duhet të përfshijë:

- Rezultatet e të mësimit
- Lista e Kriterit të Përformancës (Vlerësimi))
- Kushtet e realizimit të funksionit
- Kërkesat e dëshmime

⋮ A. INFORMACIONET E PËRGGJITHSHME ⋮

⋮ TITULLI I MODULIT ⋮

Titulli i programit duhet të ofroj informata të qarta rreth natyrës së gjerë të rezultateve të kërkuara. Titulli duhet të jetë i ngjeshur dhe i qartë dhe ku është e mundur duhet të bart lidhshmërinë profesionale të kualifikimit p.sh. **Reklammat dhe Promovimi** (nga Korniza e Kurrikulit për Administrim Biznesi).

Në shumë raste dhënia e kualifikimit përfshinë më tepër se një fushë profesionale, p.sh vendimi i certifikatës së biznesit mund të përfshij kompetencat e lidhura me administrimin financiar dhe auditimin , andaj titulli do të bëhej **Sistemet financiare dhe Auditimi**. Duke treguar se fusha kryesore është financa, por teknikat e auditimit janë dukshëm të zhvilluara.

⋮ DATA ⋮

Data tregon muajin dhe vitin në të cilin Specifika e modulit është validuar dh është rruga kryesore përmes

së cilës shkollat mund të bëjnë identifikimin e versionit aktual.

⋮ DEKLARATA E NIVELIT ⋮

Deklarata e nivelit që i bashkëngjitet modulet i referohet ndërlíkueshmërisë së modulit, për rastet kur moduli është pjesë e serisë me fokus të ngjashëm. Ne mund të kemi module të ndryshme me titull të njëjtë por që dallohen përmes nivelit, pra **Komunikimi 1**.

Komunikimi 2. Arsyeja pse ne e bashkëngjimis deklaratën e nivelit në module me të njëjtin emër është që ti vendosim ato në kualifikime. Deklarata nivelit **nuk** është komponentë obligative për modulën dhe **nuk** duhet të përzihet me nivelin e kualifikimeve.

VLERA E KREDISË

Vlera e Kredisë është e caktuar në Specifikat e Modullit. Kjo tregon niveli e kërkesës së bërë nga përmbajtja e Rezultateve të Mësimit dhe kohëzgjatjen e dizajnit për ta përfunduar atë.

Kohëzgjatja e dizajnit joreal përfshin të gjitha aktivitetet e mësimdhënies dhe mësim mësimit përfshirë të dyja – vlerësimin formativ dhe sumativ.

Sidoqoftë, koha shtesë mund të jete e nevojshme nga disa nxënës për konsolidimin e mësim mësimit në formë të punës praktike apo vetë-mësimit.

Kohëzgjatja e dizajnit joreal për një kredi, për kualifikimet e AAP në Kosovë është 10 orë.

DEKLARATA E QASJES

Deklarata e qasjes është përdorur për të treguar ku është e nevojshme për nxënësit të arrijnë shkathhtështë ose njohurinë e caktuar para regjistrimit në atë Modul. Deklarata e qasjes duhet të reflektoj synimet rreth pikës së fillimit për ofrimin e Modullit.

Kur ka parakushte specifike modulare pa të cilat nxënësi vështirë se mund ta kompletoj programin, atëherë kjo duhet të ceket në Deklaratën e Qasjes, duke cekur titullin e plotë të modullit të nevojshëm për qasje. P.sh.

Shembulli 1

Komunikimi i Biznesit 1

Deklarata e Qasjes : Qasja hynë në kuadër të zgjidhjes së shkollës. Megjithatë kjo do të ishte e dobishme nëse nxënësi ka përfunduar me sukses arsimin e detyrueshëm.

Shembulli 2

Komunikimi i Biznesit 2

Deklarata e Qasjes : Qasja hynë në kuadër të lirisë së veprimit /ose zgjedhjes së shkollës. Megjithatë kjo do të ishte e dobishme nëse nxënësi ka përfunduar me sukses Modulin për Komunikim Biznesi 1.

PARATHËNIE E MODULIT

Parathënie e modulit duhet të jap një deklaratë të qartë mbi shkathtësitë dhe dijen e përgjithshme që duhet të demonstrohet nga nxënësi dhe duhet të përmbaj një përmbledhje të shkurtër të informatave nga Rezultatet e Mësim mësim.

Shembulli 3

Marketingu

Hyrja /ose Parathënia e Modulit: Me përfundimin e këtij moduli nxënësi duhet të jetë në gjendje të përshkruaj konceptin e marketingut, aktivitetet bazike të marketingut dhe aktivitetet e marketingut të një organizate biz nesore.

Hyrja në modul duhet të filloj me parathënien si: "Me kompletimin e këtij moduli nxënësi duhet të jetë në gjendje të..."

Shembulli 4

Shkathtësitë personale dhe ndër-njerëzore

Hyrja e Modulit: Me përfundimin e këtij moduli nxënësi duhet të jetë në gjendje të përdor shkathtësitë personale dhe ndër-njerëzore në situata normale të punës , përfshirë edhe zgjidhjen e problemeve dhe bashkëpunimin me të tjerët.

REZULTATET E MËSIMIT

Rezultatet e të mësimit janë bërthama e modulit. Ato përshkruajnë të arriturat e nxënësit me përfundimin e modulit, për sa i përket njohurive, shkathtësive dhe të kuptuarit. Zakonisht një modul përmban 3-5 rezultate të mësimit.

Komponentët e rezultateve të mësimit

Komponentët e përgjithshme të rezultateve të mësimit janë:

Veprimet	Çfarë është ajo që personi pritët ta bëjë?
Situatat	Cilat janë rrethanat brenda së cilave pritët të veproj personi?
Cilësia	Çfarë është niveli i performancës që një person pritët ta arrij?
Njohuria dhe të menduarit	Çfarë duhet të kuptoj personi në mënyrë që të kryej detyrën me kompetencë?

Shembulli 5

Një kompetencë në industrinë e transportit rrugor mund të përfshijë funksionin vijues, aktivitetin kyç, kriterin e performancës, dhe deklaratën kontekstit.

Hyrja e Moduli: Me përfundimin e këtij moduli nxënësi duhet të jetë në gjendje të përdor shkathtësitë personale dhe ndër-njerëzore në situata normale të punës, përfshirë edhe zgjidhjen e problemeve dhe bashkëpunimin me të tjerët.

Funksioni	Manovrimi i Mjeteve të Rënda
Aktiviteti Kyç	Kriteri i Performancës
Këmbim dhe shpërndarje e ngarkesave	Përfundo në mënyrë të sigurtë dhe efikase manovrat e makinave duke bërë kthimin mbrapa/ ndryshimin.
Deklarata e Kontekstit: Veturat me rimorkio mbi 5 ton; Hyrjet jashtë rrugës; rrugët e ngushta, lakesat dhe kthesat .	

Një rezultat i të mësimit i cili rrjedh nga këto të dhëna mund të jetë:

'Për ta kthyer një kamion me rimorkio në ambiente të zëna dhe të qeta, në mënyrë të përsëritshme, pa shkaktuar ndonjë rrezik, ose bllokim të trafikut përreth'

Komponentet e këtij rezultati të të mësimit janë:

Veprimet	Kthimi i një kamioni me rimorkio
Situatat	Ambiente të zëna dhe të qeta.
Cilësia	Në mënyrë të përsëritur pa shkaktuar rreziqe ose bllokim të trafikut përreth.
Njohuria dhe të menduarit	Parimet e sigurisë në rrugë; rreziqet e mundshme; duke llogaritur distancën nga trotuari; ndërprejet në rrjedhën e trafikut.

Shembulli 6

Një funksion në kuadër të profesionit asistent –zyre mund të jetë:

Funksioni	Përdorimi i TI-së për të këmbyer informatat
Elementi	Kriteri i Performancës
Pranimi dhe dërgimi i postës elektronike	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përdor komandat bazike për dërgesë si dërgimi tek individët, dërgimi i kopjeve ▪ Përdor komandat e kthimit të informacionit, sikurse pranimit, pasimit, kthimi i përgjigjes tek individët, të gjithëve, dhe përgjigje me historik ▪ Fshirja e postës elektronike ▪ Hap dhe dërgo postën elektronike me bashkëngjitje ▪ Ruaj pjesët e bashkëngjitura në vende të duhura ▪ Gjej postën elektronike ▪ Ndiq çdo rregull dhe udhëzim për dërgimin dhe përgjigjen e postës elektronike
Kushtet e realizimit të funksionit: Materialet e bashkëngjitura të formateve të ndryshme dhe të ngjeshura, Rregullat dhe rregulloret për ruajtjen e të dhënave, të drejte e kopjimit .	

Një rezultat i të mësimit nga këto të dhëna mund të jetë si në vijim:

'Harto postën elektronike, bashkëngjitë dosjet dhe dërgo në destinacionin e shumta duke përdorur metodën e dërgimit cc dhe bcc'

Komponentet e këtij rezultati të të mësimit janë:

Veprimet	Harto dhe dërgo postat
Situatat	Me apo pa bashkëngjitje Për një apo destinacionet të ndryshme duke përdorur metodën e dërgimit cc dhe bcc
Cilësia	Duke përfillur rregullat e organizatës për formatet, destinacionet, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të kompanisë, si dhe të drejtën për kopjim
Njohuria dhe të menduarit	Opsionet bazike për dërgimin dhe përgjigje Si të dërgohen materialet e bashkëngjitura Si të përdoret libri i adresave Përse disa përdorues të kompjuterit mund të kenë vështirësi gjatë dërgimit të postës dhe materialeve shtesë të bashkëngjitura Rreziqet në shkëmbimin e informatave siç janë të dhënat personale Ku dhe kur të kërkohet këshilla Çfarë lidhe dhe udhëzime ndikojnë në përdorimin e përditshëm të TIsë, të tilla si mbrojtja e të dhënave, mundësitë e barabarta, aftësinë e kufizuar, shëndet dhe siguri, të drejtën e kopjimit, dhe udhëzuesit e caktuar nga punëdhënësi ose organizatat

KRITERI I PËRFORMANCËS/REALIZIMIT

Kriteri i Përformancës i tregon lexuesit rreth standardit minimal të arritjes i cili duhet të demonstrohet nga ana e nxënësit për të përmbushur kërkesat e Rezultatit të të mësimit si rezultat, Kriteri i Përformancës duhet të buron drejtpërdrejtë nga Rezultati i të mësimit.

Ne rekomandojmë 4 – 6 kritere të përformancës për një rezultat të mësimit varësisht nga natyra e Rezultatit të Mësimit. Kriteri i Përformancës dhe të përputhet me Rezultatit e të mësimit. Pra ato nuk duhet të përmbajnë asgjë më tepër ose asgjë më pak sesa që sugjerohet nga Rezultati i të Mësimit.

Kriteri i Përformancës duhet të tregon qartë se çfarë duhet të bëjë nxënësi dhe që standardi që ai/ajo ka arritur, është i dhënë në formën e një deklaratë vlerësuese p.sh. saktë, korrekt, qartë dhe në mënyrë të përshtatshme etj.

Secili kriter i Përformancës duhet të filloj me foljen e veprimit (shiko Shtojcën 1) ku është specifikuar se çfarë nxënësi duhet të bëjë , për shembull , sqaroj, përshkruaj, radhit etj. Folje vepruese shpesh herë do të përcaktoj nivelin e ndërlikueshmërisë dhe kompleksitetin për Rezultatit e të Mësimit.

Shembull i Kriterit të Përformancës të (Modulit Ndërmarrësi)

Rezultati i të Mësimit 2:

Identifiko një mundësi të mundshme për themelimin e një biznesi të vogël dhe vlerësoni faktorët përkatës.

Kriteri i Përformancës:

- Identifikoni një mundësi tregu të mundshme (dhe reale) për themelimin e një biznesi të vogël.
- Identifikoni shkathtësitë dhe njohuritë e kërkuara për një individ për fillimin e biznesit për të shfrytëzuar mundësinë.
- Analizoni dhe vlerësoni rreziqet dhe sugjeroni strategji për shmangien e tyre.
- Vlerësoni njohurinë dhe shkathtësitë në lidhje me mundësinë, duke marr parasysh vetëvlerësimin e karakteristikave të sjelljeve të dikujt në harmoni me vetë-punësimin.

KRITERI I PËRFORMANCËS/REALIZIMIT

Kushtet e realizimit të funksionit është dizajnuar për të siguruar gjerësinë dhe thellësinë e arritjes së shkathtësive, njohurive, dhe të kuptuarit e kërkuar nga Rezultati i të Mësimimit është përfshirë. Kjo përkufizon parametrat brenda së cilëve nxënësit duhet të jenë në gjendje të performojnë.

Çdo gjë e shkruar në Kushtet e realizimit të funksionit është e obligueshme në aktivitetet e të mësimimit në kuadër të modulit. Duhet të sigurohen dëshmi për të mbuluar të gjithë artikujt në varg. Si rezultat, Kushtet e realizimit të funksionit duhet të përdoret me kujdes për të iu shmangur mbingarkesës së procesit të mësimdhënies dhe vlerësimit. Në të vërtetë kushtet e realizimit të funksionit mund të ketë implikime të burimeve për shkollat dhe si pasojë disa nga shkollat nuk do të jenë në gjendje të ofrojnë këtë modul për shkak se kërkohet të ketë pajisje të specializuara. Dhe si rezultat, vetëm vargu i gjërave më thelbësore duhet të përfshihen.

Mirëpo si rregull të pranimit mund të themi se të gjitha gjërat e shprehura në mënyrë të përgjithshme në Kriterin e Përformancës, duhet të sqarohen në kushtet e realizimit të funksionit.

Për shembull në modul: Matja dhe kontrollimi i pjesëve të metalit (nga kualifikimi për metal punues) kriter i Përformancës mund të jetë:
Kontrollimi i dimensioneve të pjesëve të metalit duke përdorur mjete të përshtatshme për matje.
Këtu mjetet matëse të përdorura nga nxënësi duhet të shpjegohen në kushtet e realizimit të funksionit:
Vizore, rulet, mikrometër, kaliper.

Në raste të rezultateve të mësimimit: instalim i kuzhinës dhe /ose pajisjeve të banjës (nga moduli bazat themelore të hidraulikut) ndërsa në kushtet e realizimit të funksionit duhet të cekim cilat pajisje do të jenë në

gjendje t'i instaloj nxënësi dhe për çfarë do të ofroj ai dëshmi të përformancës, edhe pse lista e pajisjeve ekzistuese të banjës dhe kuzhinës mund të jetë shumë më e gjerë.

Kushtet e realizimit të funksionit:
Pajisje /Elementet : lavaman, legen, guaca e tualetit .

Në qoftë se është e domosdoshme të identifikohet kushtet e realizimit të funksionit, deklarata në vijim duhet të përfshihet në kuadër të Specifikave të Modulit:

Vargu apo gama e këtij rezultati të mësimimit është plotësisht e shprehur në kriterin e përformancës'.

Shembull i kushteve të realizimit të funksionit (moduli Ndërmarrësi)

Rezultati i të Mësimimit 1:

Kupton nënkuptimin e vetë-punësimimit

Kriteri i Përformancës:

Identifikon tiparet dhe shkathtësitë e kërkuara nga ndërmarrësi në përputhje me funksionin e udhëheqjes së një biznesi

Kushtet e realizimit të funksionit:

Tiparet: Kreativiteti, udhëheqësia ; vetë-mbështetja, përkushtimi, përcaktimi; motivi për tu dalluar

Shkathtësitë:

Administrative; teknike; financiare; mbajtjes së shënimeve; marketingut dhe shitjes; shërbimi i konsumatorit ; menaxhmenti strategjik, taktik, dhe operativ

⋮ KËRKESAT E DËSHMIVE

Kërkesat e dëshmime brenda specifikave të modulit përshkruajnë lloje(t) dhe sasi(në) e dëshmime e cila duhet të dorëzohet nga nxënësit për qëllime të vlerësimit.

Ekzistojnë dy mënyra për gjenerimin dhe paraqitjen e dëshmime të vlerësimit sumativ për akreditimin e një moduli përmes Bankës Kombëtare për Vlerësim (BKV):

1. Portofolit- dëshmi e vlerësimit, e prodhuar vazhdimisht përgjatë gjithë programit të mësimdhënies dhe mësim mësimi është veçanërisht i dobishëm për procesin e prodhimit dhe nxjerrjes së dëshmime të produktit.
2. Instrumentet e vlerësimit për nxjerrjen e kërkesave të dëshmime për rezultatet e të mësimi zakonisht të administruara drejtë përfundimit të modulit janë veçanërisht të dobishme për nxjerrjen e dëshmime të njohurisë dhe të kuptuarit.

Hartuesit e moduleve duhet të bënë shumë të qartë se kërkesat e dëshmime me metodë (at) duhet të përdoren nga vlerësuesit për nxjerrjen /prodhimin e dëshmime.

Udhëzime shtesë rreth zgjedhjes së metodës së vlerësimit janë siguruar dhe shpjeguar në Shtojcën 2.

Kur shqyrtojmë llojin e kërkesave të dëshmime të domosdoshme dhe metodën për mbledhjen (portofolin / instrument i vlerësimit) duhet ti bëni vetes tri pyetje:

1. Çfarë duhet të prodhoi nxënësi? A e kërkon Rezultati i të Mësimi prodhimin e ndonjë gjëje? Nëse po çfarë dhe sa herë? Kjo duhet të detajzohet në kërkesat e dëshmime p.sh. Dëshmia e produktit e cila tregon se nxënësi mund të ndërtoj një mur 2 deri 5 m. Në këtë rast, vlerësimi do të bazohet në cilësinë e produktit vetvetiu.

2. Çfarë duhet të bëjë nxënësi? Në rezultatit e të mësimi a përfshihet vlerësimi i nxënësit gjatë kryerjes së detyrës p.sh. bën, ndërton, zhvillon, përdor , etj? Nëse po, atëherë do të kërkohe dëshmia e Përfomancës së vërtetë. Kjo natyrë e përfomancës dhe sa herë kërkohe ajo duhet të sqarohen në mënyrë të qartë. P.sh. Të merr pjesë në një grup dhe në debate sy në sy. Lloji i dëshmime do të duket përgjithësisht si një listë e kontrollit të plotë.

3. Çfarë duhet të di nxënësi? A kërkohe dëshmia për të treguar se nxënësi ka njohuri dhe të kuptuarit e përshtatshëm? Nëse po, atëherë merrni parasysh dëshmitë në formën e shkruar /ose ato në formën verbale.

Secili program mund të planifikohet për të identifikuar se cilat module janë të përshtatshme për portofolin e dëshmime dhe cila module janë të përshtatshme për instrumente të vlerësimit. Kërkesat e dëshmime duhet lidhen drejtpërdrejtë me rezultatit e të mësimi dhe kriterin e përfomancës.

Një listë e metodave të vlerësimit me përparësitë dhe dobësitë për secilën është prezantuar në Aneksin 2 të këtij dokumenti.

Përkthimi i standardit profesional në standard të mësim mësim

(rezultatet e të mësim, kriteri i performancës/ vlerësim, gama, njohuria, të kuptuarit , strategjia e vlerësim).

Zhvilluesit e trajnimit dhe plan programit nganjëherë krijojnë lidhje ndërmjet standardeve, fokusit të aftësim, rezultateve të mësim dhe vlerësim në një përpjekje për të krijuar një lloj simetrie ndërmjet standardit dhe programit mësimor.

Funksioni	→	Titulli i Modullit ose Programit
Aktivitetet kyçe	→	Rezultatet e të mësim
Kushtet e realizimit të funksionit	→	Kriteri i (vlerësim) dhe Performancës
Udhëzuesi i Vlerësim	→	Kushtet e Performancës dhe vlerësim
Udhëzuesi i Vlerësim	→	Kërkesat e dëshmime

Në praktik, megjithatë, këto raporte mund të mos përputhen domosdo me këtë model. Zhvilluesit duhet të përdorin gjykimin e tyre duke u bazuar në nevojat e veçanta të tyre gjatë vendosjes se si të përdoret një sërë standardesh profesionale për zhvillimin e rezultateve të mësim të një moduli.

- Disa aktivitetet kryesore mund të përkthehen lehtë në rezultate të mësim;
- Disa aktivitetet kryesore mund të kombinohen për të prodhuar një rezultat të vetëm të mësim;
- Një aktivitet kyç mund të zërthehet në disa rezultate të mësim;
- Një ose më tepër kriter të performancës mund të përdoren për të formuluar një rezultat të mësim;
- Një kriter i vetëm i performancës mund të jetë bazë për disa rezultate të mësim.

Arsyeja kryesore për këtë varg të zgjedhjes është se standardet janë burim për arsim dhe aftësim më shumë sesa një metodë përshkruese.

Diversiteti i tillë krijon një sfidë për plan programin dhe zhvillimin e programit me qenë se secila kompetencë mund të prodhoj programe të ndryshme të mësim të cilat qojnë në të njëjtin rezultat, dmth vetë kompetencë.

Megjithatë në praktikë vetëm një numri i vogël i programeve aftësuese zhvillohen. Arsyeja kryesore për këtë qëndron tek burimet sepse ato janë shpesh të kufizuara dhe zhvilluesit tentojnë të përdorin programet e disponueshme sesa t'i shpikin të rejtat. Sidoqoftë ajo që mbetet është mundësia e zgjedhjes alternative për zhvilluesit.

Duke përdorur TI-në për këmbimin e informacioneve, faqet në vazhdim përshkruajnë procesin e zhvillimit të rezultateve të të mësim. Veçori kyçe e procesit është se kompetenca është analizuar dhe interpretuar.

Funksioni	Përdorimi i TI-së për këmbimin e informatave
<p>Aktiviteti Kyç: Pranon dhe dërgon posten elektronike</p>	<p>Kriteri i Përformancës Përdorni komandat themelore për dërgim, si dërgo tek individët, dërgo kopjet Përdor komandat bazike të përgjigjes, të tilla si prano, paso, përgjigju individëve, përgjigju të gjithëve dhe përgjigju me historik.</p> <p>Fshij postën elektronike</p> <p>Hap dhe dërgo postën elektronike me materialet e bashkangjitura</p> <p>Ruaj të dhënat/ materialet ose artikujt e bashkangjitur në vende të përshtatshme Gjej postën elektronike / shkresat</p> <p>Ndiqui rregullat dhe udhëzimet për dërgimin dhe kthimin e përgjigjes së shkresave / postës elektronike</p>
<p>Aktiviteti Kyç: Hulumto për informacione në Internet ose intranet</p>	<p>Kriteri i Përformancës Përdorni butonin e kërkimit për të gjetur dhe selektuar informacionet e duhura.</p> <p>Përdorni teknika të ndryshme për ta lehtësuar gjetjen e informacioneve të dobishme përsëri. (p.sh.vegëzat favorite) dhe të ua përcjell të tjerëve(p.sh dërgon ueb- faqet dhe vegëzat përmes postës elektronike) Mbani të dhëna në lidhje me origjinën e informacioneve të dobishme</p> <p>Ruani rezultatet e kërkimeve, kështu që informacionet e dobishme mund ti gjeni përsëri.</p>

Zhvillimi i Rezultateve të Mësimit

Kontrolloni dhe rishqyrtoni kompetencat për të përcaktuar rezultatet e të mësimit të Përdorimit të TI-së për këmbimin e informacioneve			
<p>Parimet aktive</p> <p>1. Përzgjedhja: Në çfarë niveli duhet të zhvillohen rezultatet e të mësimit , funksioni, kombinimi i funksioneve, aktiviteti kyç, kombinimi i aktivitetit kyç</p> <p>2. Interpretimi: Cili është fokusi i rezultateve të kursit</p> <p>3. Rezultate : Shqyrtoni rezultatet e lidhura me aktivitetet, çfarë është dhënë në kriterin e përformancës , në aktivitetet kyçe dhe funksionet e përzgjedhura si fokus i rezultateve</p> <p>4. Transferueshmëria : A e mbulon rezultati vargun e konteksteve , dmth a mundet individit ta transferoj këtë kompetencë në situata të ndryshme të punës.?</p> <p>5. Integrimi : A d të kërkoj ecuria e rezultateve paraqitjen e gjykimeve të bazuara në njohuri dhe të kuptuarit?</p>	<p>Rezultati i shoqëruar me kompetencë mund të jetë</p> <p>Pyet Radhit rezultatet e mundshme të të mësimit</p> <p>1.Punoni në adresë elektronike duke dërguar, pranuar, duke transferuar dhe ruajtur dokumentet e bashkangjitura. ----- 2. Gjeni dhe merrni informatat nga interneti ose intraneti duke përdorur opsionin e shfletimit. të ueb-faqes ----- 3.Shpjegoni kërcënimet e mundshme teknike gjatë kërkimit në internet dhe/ ose regjistrimit në ueb-faqet komerciale (përfshirë saktësinë e informacioneve, mesazhe kontradiktore.)</p> <p>4 Sqaro aspektet ligjore rreth këmbimit të informacioneve private në internet dhe intranet (aspektet e fshehtësisë, të drejtën e kopjimit etj.</p> <p>5.-----</p>	<p>Udhëzim</p> <p>Cili është ekuilibri mes të njohurive dhe përformancës në këto rezultate;</p> <p>Çfarë gjykimesh duhet të sjell i trajnuari apo rekruti.</p> <p>A është rezultati i mësimit drejtpërdrejtë i lidhur me kompetencat në standardin profesional</p> <p>Si janë të identifikuara kërkesat e kriterit të përformancës në rezultat</p> <p>A tregon rezultati se performanca duhet të jetë pjesë e procesit me një varg rrethanash , pra atë që një person pritet ta bëjë në vend të punës?</p> <p>A e përshkruan rezultati një veprimtari të gjerë ?</p> <p>A e përfshinë përdorimin e të menduarit dhe gjykimin?</p> <p>Çfarë lloje të njohurive pritet që personi të ketë për ta kryer këtë njësi?</p> <p>Cilat janë kontekstet në të cilat personi duhet të veproj</p>	<p>Shënimet:</p> <p>Shkruaj pika të rëndësishme gjatë mendimit tuaj</p> <p>Funksioni është në lidhje me pranimin dhe dorëzimin e informacioneve duke përdorur adresën e postës elektronike, gjatë hulumtimit për informacione të caktuara në internet apo intranet dhe duke vepruar me anën e mjeteve kërkimore.</p> <p>Kuptimi i përdorimit i objekteve shfletuese të ueb faqeve. Të kuptuarit e rregullave vijuese të organizatës dhe rregulloret e drejtës së kopjimit janë po ashtu vendimtare. Kompetenca sugjeron se personi duhet të jetë në gjendje të ketë qasje në informacione, shkarkoj dhe ngarkoj të dhëna me minimumin e kërcënimeve për integritetin e softuerit kompjuterik dhe rrjeteve vendore. Kompetenca poashtu nënkupton se përdoruesi duhet të jetë në gjendje të mendojnë në mënyrë të qartë dhe objektive , duhet të merren parasysh aspektet ligjore si dhe procedurat e organizatës, kanë një ide të qartë në lidhje me atë që kërkohet në hulumtimin dhe funksionon mirë ne ueb faqe (internet dhe intranet)</p> <p>Kompetenca në këtë njësi mbulon një varg situatash dhe mjedise të ueb it gjë që do të kërkoj shumë seanca dhe ushtrime praktike.</p>

ANEKSI 1 – TAKSONOMIA E FOLJEVE SIPAS BLOOM-IT

Fusha njohëse

Njohuria		Të kuptuarit	
Numëroj	Lexoj	Klasifikoj	Interpretoj
Përkufizoj	Kujtoj	Citoj	Gjej
Përkruaj	Lexoj	Konkludoj	Kuptim të
Vizato	Regjistroj	Shëndroj	Parafrazë
Rendis	Riprodhoj	Përkruaj	Parashikoj
Gjej	Selektoj	Diskutoj	Raportoj
Identifikoj	Sekuencë	Vlerësoj	Ri them
Etiketë	Gjendje	Shpjegoj	Rishikoj
Radhis	Tregoj	Përgjithësoj	Përmbledh
Përputh	Pamje	Jap shembuj	Gjurmoj
Emër	Shkruaj	Ilustroj	Kuptoj
Citoj			
Aplikimi		Analiza	
Veprim	Imitoj	Zbërthen	Fokus
Udhëheq	Zbatoj	Karakterizoj	Ilustrim
Artikuloj	Intervistë	Klasifiko	Konkludoj
Vlerësoj	Përfshij	Krahaso	Kufizim
Ndryshoj	Njoftoj	Kontrast	Planifikoj
Skicë	Udhëzoj	Lidh	Cek
Zgjedh	Ngjyros	Debatoj	Vë Prioritetet
Mbledh	Pjesëmarrje	Nxjerr në përfundim	Njoh
Llogaris	Parashikoj	Diagram	Hulumtim
Ndërtoj	Përgatit	Dalloj	Lidhet
Kontribuoi	Prodhaj	Diskriminoj	Ndanë
Kontroll	Siguroj	Veçoj	Nën ndarje
Demonstroj	lidh	Kontrolloj	
Përcaktoj	Raportoj		
Zhvilloj	Përzgjedh		
Zbuloj	Tregoj		
Dramatizoi	Zgjedh		
Barazoj	Transferoj		
Themeloi	Përdor		
Zgjas /shtrirje	Shfrytëzoj		

Sinteza		Vlerësimi	
Adaptoj	ndërhy	Vlerësoj	Interpretoj
Parashikoj	Zbulo	Argumentoj	Gjykoj
Kategorizim	Bëj / formoj	Vlerësoj	Parashikoj
Bashkëpunim	Model	Zgjedh	Vë Prioritetet
Kombinoj	Modifikoj	Krahaso & Kontrast	Dëshmoj
Komunikoj	Negocioj	Përfundoj	Kategori
Krahaso	Organizoj	Kritikoj	Normë
Harto	Kryej	Kritikë	Ri strukturoj
Përpilo	Plan	Vendos	Zgjidh
Ndërto	Pretendoj	Mbroj	Mbështetje
Kontekst	Prodhoj	Vlerësoj	
Krijo	Përparoi		
Dizajno	Propozoi		
Zhvillo	Ri aranzhoi		
Mjet	Rindërtoj		
Shpreh	Rifuqizoi		
Lehtëso	Riorganizoi		
Formulo	Rishikoi		
Gjenero	Rishkruaj		
Inkorporo	Strukturë		
Individualizo	Zëvendësues		
fillo	Validoj		
Integrim			

Fusha psikomotive

Vëzhgim	Gatishmëri	Përformancë e Kontrolluar	Përformancë Rutinore	Shkathtësi të Komplikuara
Zgjedh Përshkruaj Dallos Selektoj Izoloj Lidh	Fillon Lëviz Tregoj Gjendje Vullnetar	Kopjim Gjurmim Ndjek Reagim Riprodhim Përgjigje	Montoj Ndërtoj Kalibrim Ndërtim Çmontim Fiksoj Rregulloj Bluaj Ngroh Mat Përmirësoj Përziej	Adaptoj , Ndërtoj Ndryshoj, Kombinoj Ndërroj , Përbëj Re-aranzhoj, Ndërtoj Riorganizoj, Dizajnoj Rishikoj , bëj Ndryshoj

Fusha emocionale

Pranoj	Përgjigjem	Vlerësoj / çmoj	Organizimi	Përvetësimi i vlerave
Pyes Zgjedh Përshkruaj Përfill Jap Lokalizoj Emër Përgjigje Përdor Përzgjedh	Përgjigje Ndihoj Ndihmë Përputhje Diskutoj Përshëndes Ndihmë Paraqes Raportoj Selektoj Tregoj Shkruaj	Përfundoj Demonstroj Sqaroj Zbatoj Formë Inicij Bashkëngjis Justifikoj Propozoj Selektoj Ndaj Punoj	Aderoj Ndryshoj Aranzhoj Kombinoj Mbroj Sqaroj Integroj Modifikoj Urdhëroj Organizoj Lidh	Veproj Diskriminoj Vendos Ndikoj Dëgjoj Modifikoj Performoj Praktikoj Propozoj Caktoj Pyetje Rishikoj Shërbej Zgjidh Verifikoj

ANEKSI 2 – ZGJEDHJA E METODAVE TË VLERËSIMIT

Metodat e vlerësimit duhet të radhiten me rezultatet e të mësimit për të siguruar se shkathtësitë dhe qëndrimet e zhvilluara nga nxënësit janë vlerësuar në mënyrë të qëndrueshme me dizajnin dhe ofrimin e kursit si një tersi.

Qëllimi primar është të zgjidhni metodën e cila në mënyrë më efektive vlerëson rezultatet e të mësimit

të modulit. Në vazhdim, zgjidhni metodat e vlerësimit të cilat do të jenë përputhje me qëllimet e përgjithshme të programit, dhe mund të përfshinë zhvillimin e shkathtësive kyçe (si vlerësimi kritik apo zgjidhja e problemit) dhe mbështesni zhvillimin e kompetencave profesionale (të tillë si komunikimi praktik ose puna ekipore).

Metoda e Vlerësimit	Përshkrimi	Përparësitë	Pengesat
Vlerësimi me shkrim			
Zgjedhje të shumëfishta	Kandidatët zgjedhin përgjigjen e duhur nga disa përgjigje të mundshme.	Efikas dhe i besueshëm. Lejon një mostër të gjerë të përmbajtjes.	Ndërtimi i pyetjeve mund të jetë i vështirë dhe të marr kohë.
E saktë dhe e pasaktë	Kandidatët deklarojnë nëse deklaratat janë të sakta apo të pasakta.	Shumë artikuj mund të administrohen gjatë një periudhe të kufizuar të kohës.	Mund të nxis supozimin.
Përputhja	Kandidatët selektojnë një deklaratë të dytë e cila më së miri e plotëson çdo deklaratë të paraqitur.	Lehtë për tu administruar dhe për të arrit rezultatit. Notimi është objektiv.	Zgjedhjet e shumëfishta kërkojnë njohjen e përgjigjes së para-ndërtuar.
Plotësoni pjesën e zbrazët	Kandidatët përfundojnë frazat dhe fjalitë duke e plotësuar pjesën e zbrazët	Matni njohuritë e ndërlidhura me rezultatet e mësimit më specifike dhe kompetencat.	E saktë ose e pasaktë ka mundësi të arrij 50% përveç nëse përshtatet dhe faktet mund të mos jenë të sakta ose të pa sakta.
Përgjigjeje e shkurtër	Kandidatët japin përgjigje të shkurtra për pyetjet ose fjalitë e plota.	Mund të shkruhet për të testuar të gjitha nivelet e taksonomisë njohëse.	Nuk është i përshtatshëm për nivel më të lartë të menduarit, performancës ose rezultateve të pozicionuara.
		Kërkon ri-mbledhjen e përgjigjeve të sakta. Relativisht i lehtë për t'u ndërtuar. Supozimi i minimizuar. Lejon marrjen e mostrave të gjera të përmbajtjes. Teston aftësinë e kandidatit për të organizuar, hartuar dhe shkruar sesa thjeshtë për t'i njohur dhe rikujtuar atë.	E vështirë për t'u arritur. Tendencë për të vënë në pah njohuritë faktike, në vend të shkathtësive të larta të menduarit, Performancës ose qëndrimet.

Ese /hartim	Kandidatët i përgjigjen pyetjeve ose udhëzimeve duke organizuar dhe shkruar përgjigjen.	E lehtë për t'u përgatitur. Kandidatët përdorin fjalorthin e tyre. Mat të mësimit kompleks dhe kognitiv. Eliminon supozimin.	Testimi është i kufizuar në një mostër të ngushtë të përmbajtjes. Mund të inkurajoj „zgatjen“. Vështirë për tu vlerësuar objektivisht ose për të arritur besueshmëri në notim, andaj nevojiten udhëzues të mirë të notimit, modele të përgjigjeve dhe kritere të qarta. Favorizon kandidatët me shkathtësi të larta gjuhësore.
Provimet Gojore			
Test gojor i strukturuar	Kandidatët i përgjigjen pyetjeve aktuale (dhe përgjigjeve). Shënime do të mbahen mbi përgjigjet e dhëna.	Tendon të jetë më i besueshëm sesa një test gojor jo i strukturuar. Siguron vlerësim të drejtpërdrejtë të njohurive dhe shkathtësive të veçanta.	Më pak personale Kërkon shkathtësi të aftësimit dhe intervistimit dhe Kërkon aftësim në shkathtësitë e intervistimit dhe shkallës së vlerësimit. Mund të shkaktoj ankth tek kandidati. Mund t'i avancoj kandidatët me shkathtësi të forta oratorike dhe të folur të qetë.
Intervista e Panelit	Kandidatët intervistohen nga pedagog të ndryshëm	Zbut subjektivitetin.	E kushtueshme për tu realizuar. Duhet të planifikohet procesi grupor.
Vlerësimi i produktit			
Mostër e punës	Mostra e punës sigurohet nga kandidati gjatë kryerjes së aktiviteteve të punës.	Ofron një kontekst të jetës reale. E drejtpërdrejtë, praktike dhe e përqendruar tek nxënësi. E dobishme në rastet kur njohuria dhe shkathtësitë janë të vështira për t'u vëzhguar gjatë krijimit të produktit.	Fleta e Vlerësimit është qenësore në parandalimin e kushteve jo të drejta të testimit. Nuk lejon procesin e vëzhgimit.

Portfolio ose mbledhja e dëshmime	Një koleksion i organizuar i materialeve të cilat paraqesin dhe verifikojnë shkathtësitë dhe njohuritë e fituara eksperimentalisht.	Mundëson reflektimin mbi të mësimin. Mund të demonstroj njohuri dhe shkathtësi të tërthorta.	Mund të kërkoj intervista shtesë. Kërkon shërbime të këshillimit. Mund të favorizoj kandidatët me aftësi të forta shkrimi . Kërkon aftësimin e vlerësuesit.
Vetë-vlerësimi			
Vetë-vlerësimi	Nxënësit i përgjigjen me shkrim ndaj kritereve të përcaktuara për vlerësimin e të mësimit të tyre.	Përdor mendimin kritik. Mund të përdoret në bashkëveprim me metodat tjera. Në harmoni me filozofinë e arsimit për të rritur.	Mund të mos jetë e përshtatshme për përdorim si metodë e vetme. Mund të favorizoj kandidatët me aftësi të forta shkrimi.

ANEKSI 3 – MODULI MOSTËR

Titulli i Modullit: Marketingu: Hyrje

Data: (data e validimit)

Niveli: 2

Vlera e Kredisë: (për t'u vendosur)

Deklarata e Qasjes: Qasja është zgjedhje e shkollës. Megjithatë do të ishte e dobishme nëse nxënësit do të kishin përfunduar me sukses Klasën e 9-të.

Hyrje në Modul: Me përfundimin e këtij moduli, nxënësi do të jetë në gjendje të përshkruaj konceptin e marketingut, aktiviteve bazike të marketingut, dhe aktiviteve të marketingut në kuadër të një organizate biznesore.

Rezultatet e të Mësim:

1. Përshkrimi i konceptit të marketingut
2. Përshkrimi i aktiviteve bazike të marketingut
3. Përshkrimi i aktiviteve të marketingut në kuadër të një organizate biznesore.

Titulli i Modullit: Marketingu: Hyrje

Rezultati i të Mësimit 1: Përshkrimi i konceptit të marketingut

Kriteri i Përformancës:

- (a) Përshkruan me saktësi rolin e marketingut në përputhje me rregullat e veçanta organizative.
- (b) Përshkruan me saktësi lidhjet ndërmjet marketingut dhe funksioneve tjera biznesore .
- (c) Përshkruan me saktësi procesin e marketingut në lidhje me gjetjen dhe mbajtjen e konsumatorëve.

Kushtet e realizimit të funksionit:

Procesi i marketingut: Hulumtimi i tregut, zhvillimi i produktit, strategjitë e marketingut

Kërkesat e Dëshmive: Prova me shkrim ose verbale që nxënësi mund të përshkruaj konceptin e marketingut për të mbuluar KP –ët (a) – (c) dhe të gjithë në Kushtet e realizimit të funksionit.

Titulli i Modullit: Marketingu: Hyrje

Rezultati i të Mësimi 2: Përshkruani aktivitetet bazike të marketingut

Kriteri i Përformancës:

- (a) Përshkruani saktësisht raportin ndërmjet dizajnit të produktit dhe aktiviteteve të marketingut
- (b) Përshkruani me saktësi strategjitë e marketingut për caktimin e çmimeve për mallrat dhe shërbimet
- (c) Përshkruani saktësisht aktivitetet promovuese të përdorura në marketing
- (d) Përshkruani me saktësi kanalet për shpërndarjen e mallit ose shërbimit dhe si kjo mund të ndikoj marketingun

Kushtet e realizimit të funksionit:

Strategjitë për çmimore: depërtimin në treg, hulumtimi i tregut

Aktivitetet Promovuese: reklamat, shitja personale, marrdhënjet me publikun, promovimi i shitjes

Kërkesat e Dëshmive: Prova me shkrim ose verbale që nxënësi mund të përshkruaj aktivitetet themelore të marketingut për të mbuluar KP –ët (a) – (d) dhe të gjithë në kushtet e realizimit të funksionit.

Titulli i Modullit: Marketingu: Hyrje

Rezultati i të Mësimit 3: Përshkrimi i aktiviteteve të marketingut në kuadër të një organizate biznesore

Kriteri i Përformancës:

- (a) Identifikoni saktësisht mallin ose shërbimin e ofruar
- (b) Përshkruani saktësisht strategjinë e Çmimeve
- (c) Përshkruani saktësisht aktivitetet promovuese
- (d) Përshkruani saktësisht kanalet e shpërndarjes

Kushtet e realizimit të funksionit:

Kushtet e realizimit të funksionit për këtë rezultat është plotësisht i shprehur në kriterin e Përformancës.

Kërkesat e Dëshmive: Prova me shkrim ose verbale që nxënësi mund të përshkruaj aktivitetet e marketingut të një organizate biznesi p për të mbuluar KP –ët (a) – (d)



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian

Implementuar nga:



Për më shumë informata, ju lutem na kontaktoni:

Qendra e Studentëve
Rr. Agim Ramadani p.n.
Prishtinë, 10000, Kosovë

+381 (0) 38 212 595

+381 (0) 38 213 433

www.akk-ks.net